

# **RAPORT INDIVIDUAL I KONSULTIMIT PUBLIK**

**për projektligjin:**

**“ Për Urdhrin e Agronomit në Republikën e Shqipërisë”.**

## **1. Titulli i projekt aktit**

Projektligji “Për Urdhrin e Agronomit në Republikën e Shqipërisë”.

Rregullimi dhe mbrojtja përmes ligjit të profesionit të agronomit ka ardhur si pasojë e evidentimit të nevojës për rritjen e cilësisë së shërbimeve bujqësore, besueshmërinë e ekspertizës profesionale, dhe si një garanci më e fortë në mbrojtjen e interesit publik, konkretisht në fusha me rëndësi të lartë siç janë siguria ushqimore, administrimi i tokës bujqësore dhe mbrojtja e mjedisit.

Me propozimin e projektligjit "Për Urdhrin e Agronomit" Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural sjell zgjidhjen për përforcimin dhe plotësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor në fushën e bujqësisë duke mundësuar krijimin e Urdhrit të Agronomit si një ent publik vetërregullues profesional, në të njëjtën kohë.

Objektivat që synohen të arrihen nëpërmjet këtij projektligji janë:

- a) rregullimi i ushtrimit të profesionit të agronomit dhe i profesioneve të lidhura, përmes një kuadri ligjor të unifikuar, anëtarësimit në Urdhrin e Agronomit dhe regjistrimin në regjistra të posaçëm, në funksion të mbrojtjes së interesit publik;
- b) garantimi i cilësisë, përgjegjësisë dhe etikës profesionale;
- c) mbrojtja e interesit publik në fushat e bujqësisë, mjedisit dhe ushqimit;
- ç) përafrimi i kuadrit ligjor shqiptar me praktikën dhe standardet evropiane për profesionet e rregulluara.

## **2. Kohëzgjatja e konsultimeve**

*Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.*

Publikimi i projektligjit u bë në datë 4.6.2026 dhe nëpërmjet një njoftimi të publikuar online në RENJKP, të gjitha palët e interesuara:

- organet publike;
- shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe grupet e interesit;
- personat fizikë të huaj me vendqëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, si dhe
- personat juridikë të huaj, të regjistruar në Republikën e Shqipërisë,

ishin të ftuar për të paraqitur komentet dhe rekomandimet e tyre për projektaktin, në adresën e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik.

Data e mbylljes së procesit të konsultimit ishte 2.7.2026.

Gjatë kësaj periudhe janë regjistruar 304 shikime në platformën online, por nuk janë regjistruar komente në RENJKP, por vetëm në adresën e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik.

### **3. Metoda e konsultimit**

*Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).*

Metodat e konsultimit të përdorura për projektligjin “Për Urdhrin e Agronomit në Republikën e Shqipërisë”, ishin:

- Konsultimi elektronik përmes Regjistrimit Elektronik, RENJK (4.6.2026 – 2.7.2026);
- Tryezë publike me SHASH (Shoqatën e Agronomëve Shqiptarë), 27.7.2026,
- komentet e përcjella nëpërmjet email-it.

### **4. Palët e interesit të përfshira**

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.

Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Projektligji është përgatitur nga grupi i punës me përfaqësues të MBZHR. Hartimi i projektligjit vjen si nevojë pasi kuadri ligjor aktual, përfshirë ligjin nr. 9970/2008 "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural" dhe akte të tjera sektoriale që trajtojnë veprimtaritë bujqësore në mënyrë të përgjithshme, pa vendosur standarde specifike profesionale për agronomët.

## 5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Nga procesi i konsultimit të projektligjit, ka patur rekomandime lidhur me draftin, nga SHASH, të cilat pasqyrohen në tabelën më poshtë:

| Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.) | Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku) | Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme) | Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar) | Justifikimi                                                                         |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------|
| 1. Lidhur me Regjistrin Elektronik                                                                    | Të sqarohet se çfarë do të përfshijë regjistri elektronik. Duke qenë se në                                       | Shoqata e Agronomëve Shqipëtarë (SHASH)                                                 | U pranua pjesërisht                                 | U dakordësua që funksionimi, përmbajtja dhe elementët e regjistrit elektronik do të |

|                                                           |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |                                                |                            |                                                                                                              |
|-----------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------|----------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                                           | <p>relacion parashikohet një fond prej 25 milionë lekësh për krijimin e tij, është e nevojshme të përcaktohet funksionaliteti dhe përmbajtja e regjistrimit.</p> <p>Gjithashtu, propozojmë të shqyrtohet mundësia e njehsimit të Dëshmisë së Aftësisë me NIPT-in e fermerit, me qëllim lehtësimin e punës së agronomit gjatë ushtrimit të profesionit në përditshmëri.</p> |                                                |                            | <p>rregullohen në Statutin e Urdhrit.</p>                                                                    |
| <p>2. Lidhur me pikën 4, të Nenit 4 të projektligjit.</p> | <p><b>Sqarim</b></p> <p>"Kategoritë të cilët ushtrojnë veprimtari profesionale të lidhura me atë të agronomit nuk anëtarësohen në Urdhrin e Agronomit. Ata regjistrohen në një regjistër të veçantë dhe gjatë ushtrimit të</p>                                                                                                                                             | <p>Shoqata e Agronomëve Shqipëtarë (SHASH)</p> | <p>U pranua pjesërisht</p> | <p>U dakordësua që përcaktimi i profesioneve të lidhura me agronominë do të bëhet në Statutin e Urdhrit.</p> |

|                        |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |                                         |          |                                                                                                                                                                       |
|------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------|----------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                        | <p>profesionit të tyre ata i nënshtrohen rregullave sipas përcaktimeve në Statut."</p> <p>Propozojmë të përcaktohen qartë se cilat janë "profesionet e lidhura me agronominë", pasi projektligji nuk i specifikon dhe kjo mund të krijojë paqartësi në zbatim.</p>                                                                                                        |                                         |          |                                                                                                                                                                       |
| 3. Lidhur me diplomat. | <p>Projektligji flet për "diplomë universitare përkatëse", por nuk përcakton se cilat diploma japin të drejtën e regjistrimit në Urdhrin e Agronomit.</p> <p>Propozojmë të përcaktohen qartë diplomat që njihen, si p.sh.:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bachelor;</li> <li>• Master;</li> <li>• Mbrojtje Bimësh;</li> <li>• Hortikulturë , etj</li> </ul> | Shoqata e Agronomëve Shqipëtarë (SHASH) | Refuzuar | Çështja u paraqit për shqyrtim dhe u vendos që të vijohet sipas parashikimit të projektligjit për kete ceshtje pasi është e shprehur në mënyren e duhur dhe të sakte. |

|                                                          |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |                                                |                 |                                                                                                                                           |
|----------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------|-----------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <p><b>4. Lidhur me pikën 2, të nenit 9, Kreu II.</b></p> | <p><b>Sqarim</b><br/> Në ushtrimin e veprimtarisë së tyre, anëtarët e Urdhrit detyrohen:<br/> a) të garantojnë dokumentimin e rekomandimeve teknike që japin, përfshirë përdorimin e inputeve bujqësore;<br/> b) të garantojnë gjurmueshmërinë e ndërhyrjeve agronomike në nivel ferme, parcele apo kulture;<br/> c) të mbajnë evidencë të verifikueshme mbi rekomandimet, trajtimet dhe protokollet e zbatuara.<br/> Propozojmë të sqarohet mënyra e zbatimit praktik të këtyre detyrimeve.<br/> Konkretisht:<br/> • A do të mbahet një regjistër i vetëm?<br/> • Do të mbahen dy regjistra të</p> | <p>Shoqata e Agronomëve Shqipëtarë (SHASH)</p> | <p>U pranua</p> | <p>U dhanë sqarime mbi mënyrën e zbatimit praktik të detyrimeve që lidhen me dokumentimin, gjurmueshmërinë dhe mbajtjen e evidencave.</p> |
|----------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------|-----------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|

|                                            |                                                                                                                                                                                                                                               |                                         |          |                                                                                                                                                           |
|--------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------|----------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                            | <p>veçantë?</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Apo dokumentimi do të realizohet në mënyrë elektronike përmes një platforme të dedikuar?</li> </ul>                                                                                  |                                         |          |                                                                                                                                                           |
| 5. Lidhur me Nenin 10, përfaqësimi gjinor. | <p>Projektligji parashikon që zgjedhjet në organet drejtuese të sigurojnë përfaqësim në masën 30% për çdo gjini. Propozojmë të sqarohet mënyra e zbatimit të këtij kriteri në rastet kur në një qark apo strukturë nuk arrihet ky raport.</p> | Shoqata e Agronomëve Shqipëtarë (SHASH) | U pranua | U dakordësua që dispozita do të riformulohet në një mënyrë më të qartë, duke përdorur një formulim si " <b>deri në 30%</b> ".                             |
| 6. Pjesëmarrja në formimin e strukturave.  | <p>Propozojmë që shoqatat profesionale të agronomëve të kenë përfaqësim në Komisionin e Përkohshëm ose në procesin e ngritjes së strukturave të para të Urdhrit të Agronomit.</p>                                                             | Shoqata e Agronomëve Shqipëtarë (SHASH) | U pranua | U konfirmua se Shoqata Shqiptare e Agronomëve do të ketë përfaqësim dhe do të jetë pjesë e grupit të punës për ngritjen e strukturave të para të Urdhrit. |

|                                             |                                                                                                                                                                                                                                                                    |                                         |          |                                                                                                            |
|---------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------|----------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 7. Lidhur me mbrojtjen ligjore e anëtarëve. | Propozojmë që Urdhri të ketë detyrimin të mbrojë anëtarët e tij kur:<br>• kanë vepruar në përputhje me legjislacionin në fuqi;<br>• kanë respektuar standardet profesionale;                                                                                       | Shoqata e Agronomëve Shqipëtarë (SHASH) | U pranua | U dakordësua që kjo çështje do të rregullohet në Statutin e Urdhrit.                                       |
| 8. Financimi nga Shteti.                    | Projektligji parashikon financim nga shteti vetëm për vitin e parë të funksionimit. Propozojmë që financimi fillestar të zgjasë 2 vite, me qëllim garantimin e konsolidimit institucional dhe krijimin e një sistemi funksional përpara vetëfinancimit të Urdhrit. | Shoqata e Agronomëve Shqipëtarë (SHASH) | U pranua | U sqarua se financimi fillestar do të mbetet i kufizuar vetëm në vitin e parë të funksionimit.             |
| 9. Provimi i Shtetit.                       | Projektligji kërkon zhvillimin e provimit të shtetit, por nuk përcakton:<br>• kush e organizon;<br>• kur zhvillohet;                                                                                                                                               | Shoqata e Agronomëve Shqipëtarë (SHASH) | U pranua | U dakordësua që do të përcaktohen më qartë kategoritë që përfitojnë nga përjashtimi nga provimi i shtetit. |



|                                                            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |                                         |                     |                                                                                            |
|------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------|---------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                                            | <ul style="list-style-type: none"> <li>• procedurën e zhvillimit;</li> <li>• mënyrën e vlerësimit.</li> </ul> Propozojmë që këto elemente të përcaktohen qartë në ligj ose në aktet nënligjore.                                                                                                                                                                                       |                                         |                     |                                                                                            |
| <b>10.</b> Lidhur me pezullimin nga ushtrimi i profesionit | Projektligji parashikon pezullimin e së drejtës së ushtrimit të profesionit deri në 3 vite. Megjithatë nuk përcakton: <ul style="list-style-type: none"> <li>• cilat konsiderohen shkelje të lehta;</li> <li>• cilat konsiderohen shkelje të rënda;</li> <li>• kriteret mbi bazën e të cilave vendoset masa disiplinore.</li> </ul> Propozojmë që këto kriteret të përcaktohen qartë. | Shoqata e Agronomëve Shqipëtarë (SHASH) | U pranua pjesërisht | U dakordësua që kriteret dhe procedurat përkatëse do të rregullohen në Statutin e Urdhrit. |
| <b>11.</b> Lidhur me Gjobat                                | Projektligji parashikon gjoba nga 1 500 deri në 100 000 lekë. Propozojmë që të përcaktohen kriteret objektive                                                                                                                                                                                                                                                                         | Shoqata e Agronomëve Shqipëtarë (SHASH) | U pranua pjesërisht | U dakordësua që kriteret për vendosjen e gjobave do të përcaktohen në Statutin e           |

|                                              |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |                                         |                     |                                                                      |
|----------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------|---------------------|----------------------------------------------------------------------|
|                                              | <p>për vendosjen e gjobave, në varësi të natyrës dhe rëndësisë së shkeljes.</p> <p>Projektligji nuk përcakton afatet për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• regjistrimin;</li> <li>• shqyrtimin e kërkesave;</li> <li>• miratimin e regjistrimit;</li> <li>• pezullimin;</li> <li>• rikthimin në ushtrimin e profesionit.</li> </ul> <p>Propozojmë që këto afate të përcaktohen qartë, me qëllim garantimin e sigurisë juridike dhe funksionimit efikas të Urdhrit.</p> |                                         |                     | Urdhrit.                                                             |
| <b>12.</b> Lidhur me të drejtat e anëtarëve. | <p>Projektligji parashikon shumë detyrime për agronomët, por shumë pak të drejta.</p> <p>Propozojmë që në ligj të përcaktohen shprehimisht të drejtat e anëtarëve, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• mbështetja profesionale;</li> <li>• akses në</li> </ul>                                                                                                                                                                                                        | Shoqata e Agronomëve Shqipëtarë (SHASH) | U pranua pjesërisht | U dakordësua që kjo çështje do të rregullohet në Statutin e Urdhrit. |

|  |                                                                                                                               |  |  |  |
|--|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|--|
|  | trajnim;<br>• informimi<br>periodik;<br>• pjesëmarrja në<br>vendimmarrje;<br>• transparenca<br>mbi veprimtarinë<br>e Urdhrit. |  |  |  |
|--|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|--|